



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MUNDËSI APLIKIMI PËR NJË SHKOLLË VERORE NË SLOVAKI,

6-8 SHTATOR 2017

Qendra e Përbashkët Kërkimore pranë Komisionit Evropian (European Commission Joint Research Centre, JRC), në bashkëpunim me Akademinë Sllovaqe të Shkencës, do të organizojë në datat 6-8 shtator 2017 Shkollën Verore në Senec të Sllovakisë me temë: *“Migracioni dhe ndryshimet demografike - një fushë strategjike kyçe për të ardhmen e Evropës”*.

Shkolla Verore është një program ndërkombëtar, i hapur për shkencëtarë dhe politikëbërës të fushës së demografisë, të cilët janë të interesuar të kryejnë kërkime në fushën e migracionit dhe të ndryshimeve demografike. Përdorimi i studimeve në politikat që adresojnë këto fusha do të jenë tematikat e këtij viti.

Kandidatët e interesuar për këtë lloj aplikimi, duhet të jenë kryesisht punonjës të ministrive të linjës nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të kenë të paktën 2 vjet përvojë pune në fushën e demografisë dhe të kenë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze.

Organizatorët e Qendrës së Përbashkët Kërkimore (JRC) do të mbulojnë shpenzimet e udhëtimit, të akomodimit dhe të ushqimit për pjesëmarrësit nga vendet e BE-së dhe vendet e tjera të Evropës: Shqipëri, Armeni, Bosnje dhe Hercegovinë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Gjeorgji, Kosovë, Moldavi, Mali i Zi, Serbi, Turqi dhe Ukrainë.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit, ju lutemi referojuni adresës së internetit :

<http://www.ingsa.org/events/training-workshops/evidence-and-policy-summer-school-slovakia-sept>;

e-mail: JRC-KM-GEOGRAPHIC@ec.europa.eu;

Afati i fundit për aplikim është data **31 korrik 2017**.

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE